



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Njoftim për aplikim për shfrytëzim të hapësirës publike për stacione të plazhit në Velipojë

Bashkia Shkodër njofton se bazuar në VKM nr. 369 datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" dhe shkresës së Agjensisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve me nr. 140 Prot., datë 10 Maj 2017, fton të gjitha subjektet e interesuara të aplikojnë pranë Zyrave me Një Ndalesë të Bashkisë Shkodër me kërkesë për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit bashkë me dokumentacionin perkatës të listuar më poshtë

- Kërkesën e subjektit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;
- Planin e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme positive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;
- Ekstraktin e regjistrimit të subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- Vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;
- Vërtetim nga autoritetet tatimore që subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e punësuar në shërbim në stacionet e plazhit për periudhën e plazhit për vitin 2016.
- Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- Për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e plazhit, që kanë paraqitur kërkesën për rinovimin e kontratës së përdorimit të hapësirës së plazhit të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të kontratës. Për rinovimin e kontratës subjektet duhet të paraqesin:
 - o Vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore.
 - o Dokumentin monitorues të Agjensisë Kombëtare të Bregdetit dhe inpektoriatit përgjegjës për Turizmin se në lidhje me zbatimin e rregullt të kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe të përmbushjes së detyrimeve sipas VKM nr. 369 datë 18.05.2016.

V.O.: Të gjithë operatorët fizik/juridik nuk duhet të jenë debitor për taksat dhe tarifatat vendore pranë Drejtorisë të të ardhurave të Bashkisë Shkodër dhe të mos kenë detyrime sipas raportit përfundimtar të KLSH-se të ushtruar në ish komunën Velipojë në vitin 2015, si biznes dhe si individ. Mospërbushja e këtij kriteri është shkak skualifikimi. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të gjithë të interesuarit ju bëjmë me dije se aplikimi është i mundshëm nga data 18.05.2017 deri në datën 29.05.2017.

